



UNIVERSITETI I GJAKOVËS
"FEHMI AGANI"
UNIVERSITY OF GJAKOVA

Rr. Ismail Qemali, pn 50 000 GJAKOVË, Republika e Kosovës
Tel: 038 200 20 831; www.uni-gjk.org

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Mazllom Kumnova

Nr.Prot.: 05/577
Datë 12/05/2020

Këshilli i Drejtues i Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", bazuar në nenin 17. pika 3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", në mbledhjen e mbajtur më 22.05.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Lejohet si botimi i veçantë, publikimi i librit me titull: "Dukuri të reja kriminale në shoqërinë kosovare-vështrim antropologjik dhe kriminologjik" me autor Dr. Sci. Bekim Avdiaj, mësimdhënës i angazhuar në UGJFA.
- II. Libri nga pika I e këtij vendimi do të përmbajë: emrin, logon dhe ISBN-në e Universitetit të Gjakovës, në pajtim me vendimin e Senatit të Universitetit nr.04/575 të datës 22.05.2020.
- III. Universiteti i Gjakovës do të mbështesë botimin e 200 kopjeve të librit nga pika I e këtij vendimi, prej të cilave 150 kopje do t'i mbesin UGJFA-së, dhe 50 kopje do t'i dorëzohen autorit.
- IV. Financimi i botimit do të bëhet nga mjetet e buxhetit të Universitetit, nga kategoria e subvencioneve dhe transferove.
- V. Obligohet zyra e financave në UGJFA për zbatimin e këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues i Universitetit të Gjakovës, pasi shqyrtoi kërkesën me nr. 01/491 dt. 04.05.2020 të Dr. Sci. Bekim Avdiaj, mësimdhënës i angazhuar në UGJFA, për botim të librit me titull: "Dukuri të reja kriminale në shoqërinë kosovare-vështrim antropologjik dhe kriminologjik", i cili publikim është lejuar për botim nga KF i Filologjisë dhe Senati i Universitetit ka lejuar përdorimin e emrit, logos dhe ISBN-së UGJFA-së, e konsideroi të arsyeshme kërkesën, për arsye se Universiteti i Gjakovës mbështet botimin e publikimeve të veçanta të karakterit profesional, shkencor, letrar, dhe artistik. Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendimi t'i dërgohet:

1. Dr.Sci. Bekim Avdiaj;
2. Menaxhmentit të UGJFA-së;
3. Dekanit të F. Filologjisë;
4. Zyrës së financave të UGJFA-së;
5. Arkivit të UGJFA-së.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Prof. Asoc. Dr. Mazllom Kumnova

